



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0293

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Agon Ramadani - Anëtar dhe Kimete Gashi - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE “Asfalti sh.p.k.”, me seli në Bellopojë, e parashtruar, kundër vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi - asfaltimi i rrugës Qafa e Osekut”, me numër të prokurimit 632-23-2174-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës, më 07.07.2023 mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e “Asfalti sh.p.k.”, me nr. 2023/0293, e datës 20/05/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi - asfaltimi i rrugës Qafa e Osekut”, me numër të prokurimit 632-23-2174-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) -Komuna e Gjakovës.
- 2.Mbetet në fuqi, Vendimi e AK-së i datës 04.05.2023, për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit të sipër shënuar.
- 3.Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Me 17.03.2023, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë. Me datën 30.03.2023, AK ka publikuar formularin për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara. Hapja e ofertave është bërë me datë 05.04.2023. Me datë 04.05.2023, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi asfaltimi i rrugës Qafa e Osekut”, me numër të prokurimit 632-23-2174-5-2-1, ku është rekomanduar për kontratë OE “REA” sh.p.k. në vlerë totale prej 230000.00€. OE “Asfalti sh.p.k.”, me datën 10.05.2023, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 10.05.2023, AK - Komuna e Gjakovës me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues. I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “Asfalti sh.p.k.”, me Vendimin për dhënie të kontratës ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0293, lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrijë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedura të hapur, lloji i kontratës: Punë, vlera e parashikuar e kontratës: 289,853,00 € vlere e mesme. Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 29 maj 2023 me raportin e ekspertizës. Me datë 05.06.2023 AK Komuna e Gjakovës, ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërkaq me datë 14.06.2023, OE “Asfalti sh.p.k.”, ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 29.05.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Refuzohet si e pa bazuar ankesa e “Asfalti sh.p.k.”.
- Mbetet në fuqi vendimin e AK-së i datës 04.05.2023(*vendim për dhënie të kontratës*).

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Asfalti sh.p.k.”.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues

Pretendimin ankimor 1 Neni 1 Qëllimi, Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe, me të drejte të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla:

Përgjigja në pretendim 1 Kompania ankues “Asfalt sh.p.k.” në pretendimin e tij se është shkelur neni 1 Qëllimi i këtij aktivitetit të prokurimit eksperti shqyrtues pas analizimit mundem me

konstatuar se si qellim kanë pas të zgjedhin OE të kualifikuar, komisioni i vlerësimit gjatë fazës se vlerësimit ka respektuar kriteret me transparencë pasi OE i rekomanduar është zgjedhur sipas kriterëve të dhënies dhe kriterëve të përzgjedhjes-nen kriterëve që e kanë renditur si OE më më se shumti pikë gjatë kalkulimit. Kriteret e përzgjedhjes janë kërkesa që një OE duhet të përmbushë për të konsideruar i kualifikuar për dhënie të kontratës publike. Në këtë rast të dy OE i kanë përmbushur kriteret por piket e kanë renditur të parin OE “Rea Sh.p.k”. Sa i përket pretendimit ankimor të këtij OE mendoj që është i pa bazuar.

Nr.	Nën-kriteri	Koeficient
1	Çmimi	0.70
2	Afati me i shkurt i implementimit nga data e nënshkrimit të kontratës deri në max 180 ditë	0.20
3	Afati me i gjatë i Periudhës Garantuese deri në max 3 vite.	0.10

Pretendimin ankimor 2 AK neve na ka cilësuar si OE i përgjegjshëm që e fuqizon vetë fakti se AK nuk i ka kontrulluar kriteret e vendosura nga njësia kërkuuese duke e trajtuar të përgjegjshëm OE të Rekomanduar pa plotësuar kriterin për projekt menaxherin.

Kërkesa : Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 15 (pesëmbëdhjetë) punëtorë si dhe staf të mjaftueshëm profesional për kryerjen e projektit si në vijim.

a.) një inxhinier i diplomuar apo master i ndërtimtarisë -drejtimi konstruktiv (menaxher i kontratës dhe projektit në teren)

b.) Një inxhinier i diplomuar apo master i komunikacionit

c.) Një gjeodet i licencuar

Dëshmia e kërkuar :

Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj profesional të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhe kontrate, për projekt menaxherin duhet të ofrohet dëshmi dhe vendimi për projekt menaxherin, si dhe lista e numrit të punëtorëve të angazhuar me të

dhënat ne vijim emri, mbiemri i e punëtorit, profesioni, dhe pozicioni ne kompani. Sipas Kërkesës se AK, këta nuk e plotësojnë kriterin e kërkuar nga AK: Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa a) stafi -Menaxher i projektit. Kualifikim min. inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi Konstruktiv. Ka ofruar vetëm një dokument të lëshuar nga kompania “Rea sh.p.k”. duke emëruar Ing. Nysret Kastrati porë që nuk ka dëshmuar:

Kontratën e punës me OE (ose para kontratë) për Ing Konstruktive, nuk KA. CV e Ing ne fjale nuk e posedon, nuk ka Diplomën e projekt menaxherit Diploma Ing. Ndert. Konstruktiv nuk ka.

Përgjigjja ne pretendim 2. Në bazë të analizës se ofertës se OE të rekomanduar për kontratë ka dorëzuar Listën e stafit te punëtoreve, ne listën e stafit, ashtu siç e është kërkuar edhe ne dosjen e tenderit, mirëpo OE ankues ka si pretendim te menaxheri i kontratës dhe i projekti në teren nuk e ka kontratën dhe CV. Gjatë analizimit të ofertës se OE te rekomanduar ka dorëzuar si menaxher të projektit Nysret Kastrati – Inxh. Ndërtimtarisë Konstruktive dhe në ofertë janë të bashkangjitura Kontrata , CV dhe Diploma. Lista e stafit

1 Aolim Kastrati	Direktor	Ino i Xehelaris
2 Muie Kelmendi	Udhëheqës Teknik	Ino i Ndërtimtarisë-Hidro
3 Nysret Kastrati	Menaxher i projektit	Ino i Ndërtimtarisë-Konstruktiv
4 Gani Krasniqi	Ino i anëtarësuar për projekt	Ino i Emeritencave
5 Senad Mustafa	Ino i anëtarësuar për projekt	Ino i Komunikimit
6 Jetmir Avdall	Ino i anëtarësuar për projekt	Ino i Geodësis

Nga kjo vërehet se AK ka vepruar vlerësuar në përputhje me nenin 59 të LPP-së sa i përket këtij kriteri tekniko profesional unë si ekspert shqyrtues mendoj se është në konform kritereve të dosjes se tenderit. Unë si ekspert shqyrtues mendoj se vlerësimi është në përputhje me nenin 69 të LPP-se pasi Inxh. i ndërtimtarisë i plotëson kriterin e kërkuar ne dosjen e tenderit. Prandaj, në

përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se pretendimet e OE ankues nuk qëndrojnë.

Pretendimin ankimor 3 Kërkesa b). Inxhinier i komunikacionit ka paraqitur me kontratë të rregullt pune të datës: 01.04.2022 kontratë të rregullte pune por që pas verifikimit të të njëjtin z.Senat Mustafa me numër personal : 1231615519 ne ATK për të punësuarit nuk rezulton se asnjë kontributë - apo pagesë e tatimit në burim është paguar nga kompania “Rea sh.p.k”, ne emër të lartcekurit, pra kontrata nuk është valide.

Përgjigjja në pretendim 3 Gjate analizimit te aktivitetit te prokurimit sqarojmë se pretendimi ankimor i OE ankues për Inxh. e Komunikacionit se nuk është ne Listën e ATK-së, në si ekspert kemi analizuar këtë pretendim ankimor ku kemi konstatuar se nuk është kërkuar në dosjes se tenderit lista e stafit të punësuar nga ATK-ja dhe nuk mundet te merret si kriter i vlerësimit ky pretendim ankimor.

Në bazë të kësaj OE ankues ne pretendimin ankimor për punëtorin Senat Mustafa që nuk figuron ne listën e ATK-së që e ka paraqit në ankese është i pa bazë pasi nuk mundet të eliminohet një OE për dokumenta që nuk kanë qenë kërkesë e dosjes se tenderit. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar Diplomën për Inxh. të Komunikacionit dhe kontratën, CV dhe Diploma si që është kërkuar në DT kontrata është me afat të pa caktuar që sipas ekspertit shqyrtues në bazë të nenit 69 te LPP-së, se kompania e rekomanduar ka plotësuar kriterin e kërkuar në dosjen e tenderit e sa i përket pretendimit ankimore që OE ankues që ka parashtruar nuk është i qëndrueshëm.

Pretendimi 4 Kërkesa c). Nuk e ka plotësuar kriterin për Gjeodetin e licencuar. Në listën e të punësuarve që ka paraqite OE i Rekomanduar ka shkruar Jetmir Avdijaj, por nuk ka:

Kontratën e punës me OE (ose para kontratë) për Ing gjeodet, nuk KA. CV e Ing në fjalë nuk e posedon , nuk KA Diplomën dhe Licencën e Gjeodetit nuk ka.

Përgjigjja ne pretendim 4 Pretendimi ankimor lidhur me Inxh. Gjeodezisë ne si ekspert shqyrtues mendoj se nuk qëndron ky pretendim ankimor i OE ankues pasi kompania fituese e ka Inxh. e Gjeodezisë dhe dëshmitë që janë kërkuara ne Dosjen e tenderit Diploma, CV, dhe kontratën i ka, gjithashtu edhe ne listën e stafit është Jetmir Avdijaj.

Pretendimi 5 Edhe tek të punësuarit me para kontrata ka devijime të pa arsyetuara ku në të njëjtën kontrate paraqiten dy emra të ndryshëm dhe nuk ka përputhshmëri me kërkesën e AK , pra po të analizohet edhe ky fakt OE i rekomanduar nuk e ka plotësuar kriterin prej 15 të punësuarve, (ne pjesën e para paraqitet emri i Safet Kastratit, ndërsa ne piken vijuese Driton Sapunxhiu)

Dëshmi ka edhe disa te tjera : 5 para kontrata janë me gabime të njëjta (Faton Gashi - Fiskin Zatriqi, Valon Gashi-Hamdi Gashi, Safet Kastrati-Driton Sapungjiu , Fatmir Kastrati- Kreshnik Dugolli, Musa Gashi - Eldin Muharemi si dhe ka përsëritur punëtor me kontrata te Rregullta dhe me para kontrata dhe atë ne 9 raste të cilët kanë, para kontratë dhe Kontrate Pune dhe atë: Labinot Kastrati, Etnik Kastrati , Arbnor Gashi , Fatjon Gashi, Musa Gashi, Fatmir Kastrati, Granit Kastrati, Safet Kastrati dhe Faton gashi. Dëshmi Kontrata dhe para kontrata.

Përgjigjja ne pretendim 5 Sa i përket para kontratave që është si pretendim ankimor i OE ankues mendoj që nuk është dashur të jetë si pretendim ankimor pasi OE i rekomanduar për kontratë e ka plotësuar kriterin e dosjes se tenderit (15 punëtorë) me kontrata të rregullta të stafit që janë edhe në listën e ATK-se dhe për këtë arsye edhe AK –ja e ka pranuar si OE të përgjigjshëm. Para kontratave që i ka dorëzuar kompania e rekomanduar “Rea sh.p.k”, është një gabim teknik që nuk është dashur të merret parasysh pasi edhe Autoritetet Kontraktuese i kanë shabllonet e kontratave njëjtë për gjithë OE. Para kontratat e plotëson kushtin e kërkuar dhe është me numër personal dhe nënshkrim në rregull mirëpo mendoj unë si ekspert se OE nuk ka pasur nevojë të bëjë para kontrata pasi i ka plotësuar kushtin me kontrata dhe AK-ja nuk i ka marrë në shqyrtim para kontratat pasi është plotësuar kushti i tenderit me kontrata dhe me listë të stafit të dorëzuar me ATK-ne. Gjithashtu unë mendoj se ky pretendim është jashtë kriterëve të kërkuar në dosjen e tenderit mirëpo nëse do të merret për bazë duhet të trajtohet si devijim i vogël sipas nenit 59 të LPP-së pasi është gabim teknik i OE të rekomanduar pasi punëtorët Labinot Kastrati, Etnik Kastrati Arbor Gashi Fatjon Gashi Muse Gashi Fatmir Kastrati Safet Kastrati të gjithë e kanë kontrata të rregullta dhe janë në listë të ATK-së (Lista e ATK-së nuk ka qenë kërkesë e dosjes se tenderit). Në bazë të konstatimeve më lartë mendoj që ky pretendim ankimore është i pa bazë.

Pretendimi 5 Nëse autoriteti kontraktues ka përcaktuar në dosjen e tenderit se kontrata publike do t'i jepet operatorit ekonomik që dorëzon tenderin e përgjegjshëm ekonomikisht me të favorshëm, dhënia e kësaj kontrate do të bëhet vetëm në bazë të kriterëve dhe peshës së tyre përkatëse të përcaktuar në dosjen e tenderit në pajtim me paragrafët 2 dhe 3 të nenit 52 të këtij ligji.

Përgjigjja në pretendim 5 Në bazë të nenit 60 kriter për dhënien e tenderit ka qenë Tenderi i përgjigjshëm ekonomikisht me të favorshëm. Në bazë të kriterëve të peshave është zgjedhur OE i rekomanduar për kontratë dhe mendoj se është zgjedhur si pas kriterëve të përcaktuar në dosjen e tenderit. Nëse kriteri për dhënie të kontratës është “Tenderi Ekonomikisht më i favorshëm (TEMF)”, kontrata duhet t'i jepet tenderit i cili më së miri përmbushë kriteret relevante. Përveç çmimit, AK mund të përfshijë kriterë tjerë relevante për lëndën e kontratës. Kriteret duhet të përcaktohen me peshë sipas rëndësisë relative, me përqindje ku të gjitha nën-kriteret përbërëse arrijnë në 100 %. Autoriteti kontraktues mund të specifikojë peshën relative që i jep secilit prej kriterëve të zgjedhura për të përcaktuar tenderin ekonomikisht të favorshëm.

Pretendimi 6 AK - Nuk e ka trajtuar kërkesën për Rishqyrtim konform nenit 108/A, duke aluduar të OE i Rekomanduar për dhënie të kontratës i plotëson të gjitha kriteret.

Përgjigjja ne pretendim 6 Sa i përket këtij pretendimi AK-ja ju përgjigjur me datën 10.05.2023 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim dhe ka vërtetuar B58 Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 03.05.2023 që është përputhje me nenin 108A të LPP-së dhe pretendimi ankimor i OE ankues nuk qëndron.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK. Në bazë të fakteve dhe sqarimeve që kemi shqyrtuar, si dhe përgjigjet e cekura me lart eksperti shqyrtues mendon se Ankesa e "Asfalt sh.p.k.", të cilësohet e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi B58 Njoftim mbi Vendimin e AK-së.

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -

Paneli konstatoi senuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit dhe konsideron se janë jo kontestuese faktet se AK ka zbatuar në këtë aktivitet të prokurimit procedurën e hapur, vlerë e mesme, lloji i kontratës punë, vlera e parashikuar **289,853.57€**.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik. Në këtë rast, duke i analizuar në tërësi shkresat e kësaj lënde vërehet ankuesi ka pohuar se OE i rekomanduar nuk i ka plotësuar kushtet lidhur me kapacitetin financiar dhe pranueshmërinë e kandidatëve,

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar se në raportin e ekspertizës së tij.

Prandaj bazuar në faktet dhe rrethanat e shpjeguara shkurtimisht si më sipër, Paneli konsideron se AK nuk ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të LPP, sepse në shkresat e kësaj lënde nuk gjendet ndonjë provë se AK ka aplikuar ndonjë kriter apo veprim që diskriminon, redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik. Ankuesi ka theksuar në vijim se cituar: "...ky veprim përbën shkelje të plotë edhe të nenit 1 dhe 6 të LPP-së duke tentuar të bëj shfrytëzim jo efikas dhe jo transparent të parasë publike dhe duke tentuar që mjetet financiare të i shfrytëzoj në mënyrën më jo ekonomike të mundshme". Mirëpo nga shqyrtimi i shkresave të kësaj lënde dhe i rrjedhës së prokurimit, Paneli nuk gjeti ndonjë provë sipas së cilës mund të

konstatohet synimi i AK për shfrytëzim jo efikas dhe jo transparent të parasë publike. Ankuesi ka pohuar më tej se AK ka shkelur nenin 59 të LPP, mirëpo edhe në këtë rast, bazuar paraprakisht në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se nuk ka shkelje në dispozitën e cituar, pa nevojë për ti përsëritur shpjegimet si më sipër.

Prandaj Paneli konsideron se faktet e cituara si më sipër kanë efekt qenësor lidhur me marrjen e vendimit të AK, sepse:

- Është aplikuar kriterit *Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht* më i favorshëm, sikurse kërkohet shprehimisht me dispozitën e nenit 52 të LPP, sipas të cilit, cituar: “Autoriteti kontraktues në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit do të specifikoj kriteret që do të përdoren për dhënie të kontratës. Kriteret duhet të jenë ose çmimi më i ulët ose tenderi ekonomikisht më i favorshëm”.

- AK ka vepruar në pajtim me nenin 59 të LPP, sepse nuk ka aplikuar ndonjë ndryshim material në dosjen e tenderit sikurse parashihet me paragrafin 2, të nenit të cituar sipas të cilit “Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues”.

- *Përfundim* -

Nisur nga shpjegimet si më sipër Paneli konsideron se AK ka vepruar në harmoni me dispozitat e cituara si më sipër të LPP dhe ka zbatuar drejtë dosjen e tenderit sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 27, sipas të cilit, autoriteti kontraktues përpilon dosjen e tenderit me të gjitha informatat përkatëse përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Në kuptim të kësaj dispozite, dosja e tenderit përbën dokumentin kryesor të prokurimit dhe se publikimi i sajë supozohet të jetë në harmoni të plotë me qëllimet e LPP, të siguroj mënyrën efikase të shfrytëzimit të fondeve publike, të promovoj integritetin e vet procesit të prokurimit dhe të kulturës institucionale dhe të profesionalizuar.

Ndonëse mendimi i ekspertit nuk është detyrues, Paneli sipas mendimit të pavarur të tij e ka mbështetur raportin e ekspertit në rastin konkret, nisur nga parimi se vlera provuese e tij jepet gjithnjë me raport me vlerësimin, krahasimin dhe administrimin e të gjitha provave tjera dhe natyrën e një çështje në rastin konkret.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrur në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Paneli Shqyrtues niset gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në detyrimin e tyre eksplisit respektimi i ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur ka të drejtë që t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë në afat prej 30 ditësh, nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - Asfalti SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: